


Opozita e akuzon pozitën për mbajtje debatesh publike me shërbyes civilë



Sefer Tasholli, nënkryetar i LDK-së, Dega e Lipjanit, vlerëson se mosprania e qytetarëve në debate flet për një humbje besimi ndaj pushtetit lokal

Arian Duriqi

LIPJAN, 17 GUSHT – Pjesëtarë të opozitës në Lipjan kanë kërkuar më shumë punë nga pushteti lokal në mënyrë që të joshin qytetarët të jenë prezentë në debate publike dhe që debatet e tilla të mos mbahen në praninë e shërbyesve civilë dhe të një pjese njerëzish që opozita i vlerëson si të afërm të pushtetit.

Sefer Tasholli, nënkryetar i LDK-së, Dega e Lipjanit, vlerëson se mosprania e qytetarëve në debate flet për një humbje besimi ndaj pushtetit lokal.

“Kryesisht në debate ka më së shumti 4-5 qytetarë dhe ata nuk janë të interesuar për debat. Kështu po fitohet përshtypja se qytetarët nuk kanë interesim për debate me pushtetin, sepse e kanë humbur besimin. Marrë në përgjithësi prej 10 – 12 vetave që janë në debate, 90 përqind janë komunarë”, ka thënë ai.

Për më tepër, Tasholli ka shtuar se transparenca në Lipjan ka kohë që nuk shikohet me sy të mirë nga qytetarët e opozitarët e kësaj komune për faktin se ata vazhdojnë të mos e pëlqejnë mbushjen e sallës me shërbyes civilë në kohën kur caktohen të mbahen debatet me qytetarë. Veç kësaj, Komuna e Lipjanit javëve të fundit ka nisur dëgjimin publik të buxhetit komunal për vitin 2013 në disa lokalitete të mëdha të kësaj komune. Mirëpo, ka qenë edhe shoqëria civile që ka evidencuar mospjesëmarrje të qytetarëve në debate të tilla. OJQ YAHR, qëllimin e ekzekutivit komunal për debate në shtatë vendbanime të mëdha të Ko-

munës e sheh si të mirë, mirëpo vë në pah mungesën e informimit me kohë për mbajtjen e debateve të tilla.

“Kemi një mosinteresim të qytetarëve për pjesëmarrje në debate të tilla dhe ne kemi evidencuar disa faktorë që mund të kenë ndikim në këtë mungesë. Mosinformimi me kohë dhe jo i saktë për debatet, mospuna e kryesive të fshatrave, mungesa e njohurive të qytetarëve nëpër fshatra për rëndësinë e krijimit të buxhetit komunal dhe në fund dëshpërimi që mund ta kenë pësuar qytetarët mbi mundësinë e ndikimit të tyre në institucionet komunale”, ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR.

Nga ana tjetër, Hasan Luma shef në zyrën e informacionit publik në Lipjan ka deklaruar se kjo komunë fillimisht e ka planin e transparencës që e ka miratuar në KK dhe po i përmbahet atij plani në mënyrën më të mirë të mundshme, pavarësisht, se sipas tij, roli i opozitës është që të kritikojë në këtë plan. Sa u përket takimeve publike Luma ka thënë se numri i pjesëmarrësve nuk është për t'u nënçmuar.

“Kreu komunal ka mbajtur rregullisht debate me qytetarë sipas rregullave që jep ligji, madje ka pasur qytetarë të mjaftueshëm që edhe kanë ngritur shqetësimet e tyre në debatet e mbajtura si për buxhetin ashtu edhe për çështje të tjera. Numri i qytetarëve në takime publike nuk është për t'u nënçmuar edhe pse ne e dëshirojmë një numër ende më të madh për të mundësuar ndikimin e qytetarëve në institucionet publike”, ka thënë ai.